



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 42/2020 (JR)
Datë 30.09.2020

Vendim nr. 36 (JR)
Datë 30.09.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 30.09.2022, ditën e premte, ora 13:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino, e cila përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Valdete Hoxha*¹, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Valdete Hoxha, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht², konstaton *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete M. Hoxha (H.)*.

2.3. KLGj-ja, pasi kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin³ e hollësishëm dhe të arsyetuar, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Valdete Hoxha.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 269, datë 01.07.2020, në bazë të nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe ka

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.05.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Valdete Hoxha, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

² Me vendimin nr. {***}, datë 11.09.2019, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

³ Raporti me nr. {***} prot., datë 05.06.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit”.

një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi, *konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.*

4. Këtë vendim Komisioni e ka mbështetur në konkluzionet e arritura pas një hetimi të plotë e të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, duke konkluduar si vijon.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: Subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *vetting*, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elementë që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional, duke arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

5. Kundër vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, është ushtruar ankim⁴ në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), nga Komisioneri Publik Darjel Sina, i cili ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Përfundimet e arritura nga Komisioni, në vlerësim të Komisionerit Publik, janë rrjedhojë e një vlerësimi jo të drejtë të provave dhe një hetimi administrativ jo të plotë e shterues.
6. Komisioneri Publik kërkon nga Kolegji shqyrtimin e vendimit nr. 269, datë 1.7.2020, lidhur me nevojën e hetimit të mëtejshëm të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, administrimin e provave të nevojshme në vlerësimin e aftësisë dhe mjaftueshmërisë financiare, mënyrën e krijimit të pasurisë/likuiditeteve, si dhe shpenzimeve të deklaruara dhe atyre të rezultuara nga hetimi administrativ, me qëllim justifikimin bindshëm të burimit të krijimit, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
7. Me qëllim arritjen në një vendimmarrje përfundimtare për konfirmimin ose shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit. Në përfundim, Komisioneri Publik kërkon që Kolegji, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative: (i) *ndryshimin e vendimit nr. 269,*

⁴ *Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/08/39.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-269-dat%C3%AB-17.2020-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%AB-sr-znj.-Valdete-Hoxha.pdf>.*

datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ose (ii) lënien në fuqi të këtij vendimi.

8. Shkaqet e ngritura në ankimin nga Komisioneri Publik, konsistojnë sa vijon.

8.1. Në lidhje me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. S. J. [kunata e subjektit të rivlerësimit], për justifikimin bindshëm të huas së dhënë së bijës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. H., në shumën prej 93.952,08 CAD [dollarë kanadez], për mbulimin e shpenzimeve të studimit në Kanada gjatë viteve 2012-2016, si dhe dhurimet në shumën 11.500 CAD, Komisioneri Publik ngre këto pretendime:

8.1.1. Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues. Gjendja e provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në harmoni me *indiciet* që dalin prej tyre, e bëjnë të nevojshëm hetimin e mëtejshëm në funksion të besueshmërisë dhe provueshmërisë bindshëm të mundësisë financiare dhe burimit të ligjshëm të huas dhe dhurimit.

8.1.2. Bazuar në jurisprudencën⁵ e Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë kufijtë proporcional të kontrollit pasuror për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur dhe raportin përpjesëtimor që duhet të ketë ky kontroll me barrën e provës të subjektit të rivlerësimit, në justifikimin e pasurisë objekt huaje apo dhurimi. Sikurse dhe Kolegji ka mbajtur qëndrim në raste të ngjashme, pjesë e këtij vlerësimi duhet të jenë si të ardhurat e ligjshme dhe shpenzimet e kryera nga personi i lidhur apo tjetër i lidhur, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit, sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, rast pas rasti dhe sipas rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve kur ekzistojnë dyshime për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.

8.1.3. Kontrolli në drejtim të shpenzimeve të kryera nga familja J., në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, nuk synon vlerësimin e burimit të ligjshëm të çdo pasurie të tyre, por vlerësimin e shpenzimeve të tyre përfshirë dhe ato në vënien e pasurisë, në raport me mundësinë dhe mjaftueshmërinë financiare për të dhënë hua shumën 93.952,08 CAD, të bijës së subjektit dhe dhurimet e deklaruara.

8.1.4. Kontributi i familjes J. do të ishte në një vlerë edhe më të madhe, nëse huas financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimit, do t'i shtohej dhe mbështetja jo financiare e shpenzimeve të jetesës të së bijës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2012-2016, në rreth 50.000 CAD⁶.

Ndërkohë që për apartamentin e familjes J. në Shqipëri, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin përkatës, për investimin e kryer për shtëpinë në Kanada, nuk rezulton të jetë hetuar vlera totale dhe viti i investimit, sipas dokumentacionit të fitimit të pasurisë, duke lenë të paqartë: (i) nëse vlera totale e këtij aseti është financuar tërësisht nga kredia bankare apo janë përdorur dhe kursimet e familjes për të mbuluar shumën e paguar; (ii) viti i marrjes së kredisë dhe kohëzgjatja e saj; si dhe (iii) data e fillimit të shlyerjes së kredisë dhe kësti mujor i pagesës.

8.2. Lidhur me shlyerjen e huas në vitin 2016 dhe gjendjen e detyrimit të mbetur pashlyer nga S. H. kundrejt hallës S. J., Komisioneri Publik konstaton mospërputhje të detyrimit të mbetur, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, me atë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016. Referuar detyrimit të deklaruar në deklaratat e interesave privatë të vitit 2016 dhe 2017, deri në fund të këtyre viteve rezulton të jenë shlyer 34.706,22 CAD, nga të cilat 9.600 gjatë

⁵ Komisioneri Publik ka referuar për këtë qëllim vendimet (JR) nr. 8/2019, nr. 9/2019, nr. 14/2019, nr. 15/2019, nr. 20/2019, nr. 26/2019, nr. 28/2019 dhe nr. 4/2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁶ Bazuar në të dhënat e Statistikave në Kanada, shih: <https://www.150.statcan.gc.ca>.

vitit 2017 dhe diferenca në vlerën 25.106,22 CAD të jetë shlyer deri në fund të vitit 2016, ndërkohë që personi i lidhur, e bija e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se gjatë vitit 2016 ka shlyer shumën 13.775,48 CAD. Kjo shumë u konfirmua edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision. Mbetet e paqartë, sipas Komisionerit Publik, sa është shuma e detyrimit të shlyer nga personi i lidhur, znj. S. H., kundrejt huadhënëses S. J. deri në datën 31.12.2016.

8.3. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të personit të lidhur, znj. S. H., në bankën [kanadeze] “TD Canada Trust”, ndryshe nga sa deklarohet në deklaratën e interesave private të vitit 2016, nuk rezulton që gjatë vitit 2016, ajo të ketë kryer pagesa nga llogaria e saj në favor të personit tjetër të lidhur, znj. S. J.. Nga analiza e të ardhurave të realizuara nga znj. S. H. gjatë vitit 2016, rreth 53.000 CAD, kursimet (gjendje) në llogaritë bankare, rreth 27.000 CAD, ndërsa diferenca e mbetur ka shërbyer për shpenzime/pagesa të kryera nëpërmjet llogarisë së saj bankare, rezulton se personi i lidhur, znj. S. H., ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. Kjo pasi për vitin 2016, personi i lidhur, znj. S. H., rezulton në pamundësi financiare për të shlyer huan prej 13.775,48 CAD ndaj znj. S. J..

8.4. Lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro për blerjen e makinës “Ford Focus”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, në analizë të mjaftueshmërisë financiare, për periudhën 01.01.2011 - 19.07.2011, Komisioneri Publik konstaton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë tërhequr *cash* nga llogaritë bankare në total shumën 917.260 lekë, përfshirë këtu edhe shumën 2.971 CAD të dhuruar nga znj. S. J., ndërkohë që pagesa 7.000 euro dhe shpenzimet e tjera llogariten në shumën 1.304.351 lekë. Në këto kushte, subjekti dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën në shumën 7.000 euro, për një diferencë negative me së paku (-) 387.091 lekë.

Nëse në analizën financiare, për periudhën 01.01.2011-19.07.2011, do të përfshiheshin shpenzimet për një udhëtim të kryer nga personi i lidhur, znj. S. H., në periudhën 10.7.2011-12.8.2011, sipas jurisprudencës së Kolegjit dhe jo sa përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 47.714 lekë, diferenca negative lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro do të thellohej. Për këtë udhëtim nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të jetë pyetur gjatë hetimit administrativ apo të ketë dhënë shpjegime lidhur me destinacionin dhe mbulimin e kostove të këtij udhëtimi.

IV. KUNDËRANKIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

9. Nëpërmjet kundërankimit⁷, subjekti i rivlerësimit pretendon se shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik ngrihen mbi bazën e dyshimeve dhe hipotezave që nuk qëndrojnë në raport me provat, faktet, dokumentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provat e administruara nga Komisioni, dhe, për rrjedhojë, nuk e bëjnë të cënueshëm vendimin e Komisionit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

9.1. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, provon mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. S. J., për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe mundësinë financiare për dhënien e dhurimeve dhe huas.

9.2. Nëse Komisioneri Publik do të kishte shqyrtuar me kujdes vendimin e Komisionit nga do të ishte e qartë se shpenzimet e jetesës së personit të lidhur, znj. S. H., janë përfshirë në shumën e shpenzimeve të jetesës së familjes J. dhe nuk ka arsye që kjo mbështetje financiare të llogaritet dy herë.

⁷ Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi nr. {***}, datë 13.08.2020, për “Pranimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, për subjektin e rivlerësimit Valdete Hoxha”, më datë 03.09.2020. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision nëpërmjet postës zyrtare kundërankimin më datë 08.09.2020, brenda afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 456 i Kodit të Procedurës Civile.

9.3. Lidhur me mungesën e dokumentacionit për shtëpinë e familjes J. në Kanada, subjekti i rivlerësimit sqaron se Komisioni e ka pyetur për pasuri të S. dhe Z. J. pas vitit 2010, ndërkohë që shtëpia në Kanada është blerë në vitin 2006, me burim financimi kredi bankare, për të cilën është depozituar kopje e përditësimit të kontratës së kredisë me bankën dhe vërtetim për këstin mujor që paguhet.

9.4. Subjekti i rivlerësimit e gjen të paqartë arsyen që gjendjen e kursimeve/depozitave në bankë të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, Komisioneri Publik e lidh me mundësinë financiare të familjes J., për t'i dhënë hua për studim të bijës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. H..

9.5. Subjekti i rivlerësimit nuk e sheh të arsyeshëm konstatimin e Komisionerit Publik se familja J., që nuk jeton në Shqipëri nga viti 2002, në vitin 2010 vazhdon të ketë llogari bankare në "Raiffeisen Bank", ShA, në Shqipëri, pasi anëtarët e familjes J. janë me shtetësi shqiptare dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që të kenë llogari bankare në Shqipëri.

9.6. Lidhur me shlyerjen e huas në shumën 13.775,48 CAD, në vitin 2016, ndryshe nga sa pretendon Komisioneri Publik, personi i lidhur, znj. S. H., ka pasur mundësi financiare nga të ardhura të ligjshme për të shlyer detyrimin. Në vitin 2016, sikurse rezulton nga lëvizja e llogarive bankare të së bijës depozituar në Komision, transfertat është bërë nëpërmjet *e-transfer* nga e bija S. H. te halla e saj S. J. në datat 12.08.2016, 26.09.2016 dhe 28.11.2016 dhe nëpërmjet transfertës në llogarinë bankare të djalit të hallës, z. L. J..

9.7. Mospërputhjen e gjendjes së detyrimit të shlyer dhe atij të mbetur nga huaja, subjekti i rivlerësimit e cilëson si pasaktësi, një gabim matematikor të ndodhur për faktin se deklarata e pasurisë *vetting* është dorëzuar në janar 2017 dhe deklarata e interesave privatë e vitit 2016 në mars 2017 dhe gabimisht gjendja e detyrimit të huas së pashlyer në deklaratën e interesave privatë 2016 është zbritur nga vlera 81.600 CAD e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si detyrim i mbetur. Për pasojë, ky gabim është mbartur edhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017, por është korrigjuar më pas në deklaratën e interesave privatë të vitit 2018 dhe 2019.

9.8. Sa i përket konstatimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhurimin e shumës 3.500 CAD nga S. J. në vitin 2012, në favor të së bijës së subjektit të rivlerësimit dhe të shumës 2.970,76 CAD në favor të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit pretendon se këto shuma janë deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012 dhe janë të ardhura të ligjshme të depozituara dhe tërhequra në rrugë bankare. Këto dhurime nuk janë të ardhura të tatueshme në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe mosdeklarimi i tyre në deklaratën e pasurisë *vetting* ka qenë harresë, pa pasur qëllim fshehjen e kësaj të ardhure të ligjshme.

9.9. Pretendimi i Komisionerit Publik se për pagesën e shumës 7.000 euro për blerjen e automjetit, rezulton diferencë negative më së paku prej -387.091 lekësh, nuk qëndron. Nëse do të analizoheshin me kujdes të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, për periudhën 01.01.2011-19.07.2011, gjendja e llogarive bankare dhe gjendja *cash* e të ardhurave të akumuluar nga vitet e mëparshme, gjendje në datën 01.01.2011, si dhe dhurata në shumën 2.970,76 CAD, konstatohet se në datën 19.07.2011, disponoheshin të ardhura të ligjshme në një shumë më të madhe se 1.304.351 lekë të llogaritur nga Komisioneri Publik, për pagesën e automjetit dhe shpenzime të tjera. Nëpërmjet kundërankimit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike, me pjesëmarrjen e palëve.

12.1. Në kuadër të veprimeve përgatitore të shqyrtimit të çështjes, janë ftuar palët në këtë proces, subjekti i rivlerësimit Valdete Hoxha dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegji parashtrimet e tyre së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe akte t'u komunikohen paraprakisht palëve në proces dhe për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, për efekt të një ekonomie gjyqësore në kuadër të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor. Gjithashtu, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit iu vunë në dispozicion denoncimet nga publiku, për subjektin e rivlerësimit Valdete Hoxha, të depozituara në Kolegji.

12.2. Në gjykimin e këtij ankimi në Kolegji, Institucioni i Komisionerit Publik u përfaqësua nga Komisionerja Publike, znj. Irena Nino. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancën publike të datës 13.09.2022, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet⁸ e paraqitura në Kolegji nga

⁸ (i) Shkresë nr. {***} prot., datë 30.08.2022, të ILDKPKI-së me lëndë "Kthim përgjigje", bashkëlidhur deklaratë e interesave privatë periodikë e vitit 2018 dhe 2019; (ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.08.2021, e shtetasve Z. J. dhe S. J.; (iii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.08.2022, e shtetasve S. J.; (iv) kontratë blerje prone të paluajtshme [mes shitëses E. O. dhe blerësve Z. dhe S. J.], datë 01.05.2006; (v) kopje e certifikuar e dokumentit të pronësisë mbi banesën në {***}, {***}, Kanada, në emër të Z. J. dhe S. J.; (vi) Konfirmim për pagesat e kredisë hipotekare lëshuar nga Scotiabank, më datë 18.05.2006; [këto tri dokumente, janë paraqitur të legalizuara nga Ministria e Punëve të Jashtme, Tregtisë dhe Zhvillimit në Kanada dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kanada, dhe shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin nr. {***} rep., datë 28.07.2022 dhe vërtetim përkthimi nr. {***} datë 23.08.2022]; (vii) nxjerrje llogarie në monedhën euro [EUR] e z. Z. J. nga "Raiffeisen Bank" ShA, datë 16.07.2021 e firmosur dhe e vulosur nga banka; (viii) nxjerrje llogarie në monedhën dollarë kanadezë [CAD] e z. Z. J. nga "Raiffeisen Bank" ShA, datë 16.07.2021, e firmosur dhe e vulosur nga banka; (ix) printim i lëvizjeve të llogarisë bankare të S. H. në bankën TD Canada Trust; (x) printim i transfertës bankare me përshkrim "S. H. te J.", në TD Canada Trust; (xi) nxjerrje e lëvizjeve të llogarisë në monedhën euro të z. Z. J. [account detail] në "Raiffeisen Bank", ShA, datë 19.07.2010.

subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e datës 02.09.2022. Trupi gjykues vendosi, gjithashtu, të administrojë në cilësinë e provës edhe aktet e depozituara⁹ në Komision më datë 16.07.2020, në formën e kërkuar nga ligji, të legalizuara nga Ministria e Punëve të Jashtme, Tregtisë dhe Zhvillimit në Kanada dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kanada, të administruara pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi. Këto akte, me përmbajtje të njëjta me ato që subjekti i rivlerësimit kishte depozituar më herët gjatë procesit të rivlerësimit në Komisionin, lidhen me të ardhurat e anëtarëve të familjes J., të ardhurat e së bijës dhe të të birit të subjektit të rivlerësimit, S. H. dhe O. H., përkatësisht pagesat e faturave ndaj Universitetit i Albertës, Kanada, për studimet e tyre, kontratë shitje për një automjet të blerë nga S. H., në Kanada, në vitin 2017, si dhe marrëveshje kredie nga Scotiabank, për blerje e këtij automjeti. Depozitimi me vonesë i këtyre akteve në Komision nga subjekti i rivlerësimit është bërë për arsye të pezullimit të përkohshëm të aktivitetit të institucioneve në Kanada, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

12.3. Komisionerja Publike, e pyetur nga trupi gjykues gjatë seancës gjyqësore publike të datës 13.09.2022 lidhur me qëndrimin e saj mbi denoncimet e publikut¹⁰ të paraqitura në Kolegj për subjektin e rivlerësimit. znj. Valdete Hoxha, kërkoi kohë për t'u njohur dhe për të mbajtur qëndrim lidhur me to. Për këtë arsye, seanca gjyqësore u shty për në datën 23.09.2022, gjatë së cilës Komisionerja Publike u shpreh se denoncimet nuk përmbajnë informacione të mjaftueshme apo fakte dhe rrethana konkrete, për të kryer hetim në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit, parashtrori qëndrimin e saj, duke depozituar dhe disa akte shkresore për secilin denoncim/ankesë. Me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të administrojë në Kolegj aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në këtë seancë, konkretisht vendimin nr. {***}, datë 08.06.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë së bashku me arsyetimin paralel të subjektit të rivlerësimit, si dhe vendimin nr. {***}, datë 04.04.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë, përcjellë nga kjo gjykatë me shkresën nr. {***} prot., datë 15.07.2022. Kolegji vendosi t'i aksesojë në mënyrë të drejtpërdrejtë aktet e tjera që vijnë nga burime të hapura dhe të aksesueshme. Për sa i përket denoncimeve të paraqitura në Kolegj, trupi gjykues, me shumicë votash, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të mos çelë hetimin. Shumica e trupit gjykues çmoi që denoncimet nuk përmbajnë fakte, rrethana dhe të dhëna që përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

12.4. Në seancën gjyqësore publike të datës 23.09.2022, me parashtrimet përfundimtare¹¹, pasi vlerësoi parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të administruara në cilësinë e provës në seancën gjyqësore të datës 13.09.2022, Komisionerja Publike u shpreh se:

⁹ (i) Notice of Assessment lëshuar nga Agjencia Kanadaze e Deklarimit të të Ardhurave [Canada Revenue Agency] për S. J., për periudhën 2010-2018; (ii) Notice of Assessment lëshuar nga Agjencia Kanadaze e Deklarimit të të Ardhurave për z. Z. J., për periudhën 2010 – 2018; (iii) Notice of Assessment lëshuar nga Agjencia Kanadaze e Deklarimit të të Ardhurave për z. L. J., për periudhën 2010 – 2013; (iv) dokument nga Athabasca University, Kanada, për pagesën e muajit dhjetor 2019, për z. Z. J.; (v) dokument nga Catholic Education Services, [Edmonton Catholic School], Kanada, për pagesën e muajit dhjetor 2019 për znj. S. J.; (vi) Notice of Assessment lëshuar nga Agjencia Kanadaze e Deklarimit të të Ardhurave për zj. S. H., për periudhën 2012-2018; (vii) fatura pagese [Payment Receipt] të Universitetit të Albertës, Kanada, për znj. S. H., për periudhën 2012-2026; (viii) kontratë shitje për automjetin e markës "Volkswagen", tip "Tiguan", për znj. S. H.; (ix) marrëveshje Kredie nga Scotiabank për blerje automjeti "Volkswagen", tip "Tiguan", për znj. S. H.; (x) Notice of Assessment lëshuar nga Agjencia Kanadaze e Deklarimit të të Ardhurave për z. O. H., për periudhën 2016-2019; (xi) fatura pagese [Payment Receipt] të Universitetit të Albertës, Kanada, për z. O. H., për periudhën 2016-2020.

¹⁰ (1) Denoncim i z. A. E., nr. {***} prot., datë 14.09.2022 dhe nr. {***} prot., datë 07.10.2021, përcjellë nga Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.10.2021; (2) denoncim i z. H. R. nr. {***} prot., datë 12.07.2018; (3) denoncim i z. H. M. nr. {***} prot., datë 30.06.2021 dhe nr. {***} prot., datë 05.07.2021, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. {***} prot., datë 05.07.2021; (4) denoncim i z. A. Z. nr. {***} prot., datë 22.04.2021, përcjellë nga Komisioneri Publik, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.04.2021; (5) denoncim anonim nr. {***} prot., datë 28.06.2022; (6) denoncim i znj. N. L. nr. {***} prot., datë 19.09.2022.

¹¹ Shih: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2020/08/Bisedimet-p%C3%ABrfundimtare-dat%C3%AB-23.9.2022.pdf>

- nga aktet e administruara, nuk u konstatuan rrethana faktike që do të çonin në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni, lidhur me aftësinë e familjes J., për të mbuluar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme huat dhe dhurimet e kryera prej tyre në favor të familjes së subjektit të rivlerësimit; - lidhur me detyrimin e mbetur pa shlyer nga S. H., kundrejt hallës së saj, pretendimi i subjektit të rivlerësimit qëndron, pasi detyrimi i mbetur në fund të viteve respektivë [2018, 2019] rezulton se është korrigjuar; - pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shumat e kaluara në favor të z. L. J. kanë qenë për shlyerjen e huas së deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016, mbeten në nivel deklarativ dhe jo të provuara nga aktet e administruara. Subjekti i rivlerësimit arriti të dokumentojë vetëm një pagesë në shumën 4.400 CAD të kryer nga e bija në favor të huadhënëses S. J., fakt i cili do ta reduktonte pamjaftueshmërinë e konstatuar për shlyerjen e detyrimit në vitin 2016 nga 13.775,48 CAD në 9.375,48 CAD ose rreth 890.000 lekë; - pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e kursimeve *cash* në analizën e burimit të ligjshëm, për blerjen e automjetit në vitin 2011, nuk bazohet në sa është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011 dhe, për këtë arsye, nuk mund të pranohet. Edhe nëse merret në konsideratë pretendimi se shpenzimet e udhëtimit të së bijës janë mbuluar plotësisht nga familja J., pamjaftueshmëria e konstatuar do të ishte në vlerën (-) 387.091 lekë. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike vjetore dhe atë *vetting* [mosdeklarimi i dhurimeve], si dhe pamjaftueshmëritë e rezultuara në shlyerjen e huas në vitin 2016 e blerjen e automjetit në vitin 2011, në konsideratë të akteve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, argumentoi Komisionerja Publike. Në këto kushte, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisionerja Publike argumentoi se nuk mund të kërkohet cenimi i vendimit dhe, përfundimisht, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit. Lënien në fuqi të këtij vendimi e kërkoi edhe subjekti i rivlerësimit.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

13. Lidhur me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. S. J., për justifikimin bindshëm të huas së dhënë së bijës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. H., në shumën totale prej 93.952,08 CAD [dollarë kanadez], për mbulimin e shpenzimeve të studimit në Kanada gjatë viteve 2012-2016, si dhe dhurimet në shumën totale 11.500 CAD, Komisioneri Publik në ankim, ka pretenduar se: (i) *hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm, i plotë dhe shterues. Gjendja e provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit në harmoni me indiciet që dalin prej tyre e bëjnë të nevojshëm hetimin e mëtejshëm, në funksion të besueshmërisë dhe provueshmërisë bindshëm të mundësisë financiare dhe burimit të ligjshëm të huas dhe dhurimit; (ii) bazuar në jurisprudencën¹² e Kolegjit, Komisioneri Publik mban në konsideratë kufijtë proporcional të kontrollit pasuror për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur dhe raportin përpjesëtimor që duhet të ketë ky kontroll me barrën e provës të subjektit të rivlerësimit, në justifikimin e pasurisë objekt huaje apo dhurimi; (iii) sikurse dhe Kolegji ka mbajtur qëndrim në raste të ngjashme, pjesë e këtij vlerësimi duhet të jenë si të ardhurat e ligjshme dhe shpenzimet e kryera nga personi i lidhur apo tjetër i lidhur, i deklaruar në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit, sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, rast pas rasti dhe sipas rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve kur ekzistojnë dyshime për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur; (iv) kontrolli, në drejtim të shpenzimeve të kryera nga familja J., në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, nuk synon vlerësimin e burimit të ligjshëm të çdo pasurie të tyre, por vlerësimin e shpenzimeve të tyre përfshirë dhe ato në vënien e pasurisë, në raport me mundësinë dhe mjaftueshmërinë financiare për të dhënë hua shumën 93.952,08 CAD, të bijës së subjektit dhe dhurimet e deklaruar; (iv) kontributi i familjes J. do*

¹² Shih vendimet (JR) nr. 8/2019, nr. 9/2019, nr. 14/2019, nr. 15/2019, nr. 20/2019, nr. 26/2019, nr. 28/2019 dhe nr. 4/2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

të ishte në vlerë edhe më të madhe, nëse huas financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimit, do t'i shtohet dhe mbështetja jo financiare e shpenzimeve të jetesës të së bijës së subjektit për vitet 2012 – 2016, në rreth 50.000 CAD; (v) ndërkohë që për apartamentin e familjes J. në Shqipëri subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin përkatës, për investimin e kryer për shtëpinë në Kanada, nuk rezulton të jetë hetuar vlera totale dhe viti i investimit, sipas dokumentacionit të fitimit të pasurisë, duke lenë të paqartë, nëse vlera totale e këtij aseti është financuar tërësisht nga kredia bankare apo janë përdorur dhe kursimet e familjes për të mbuluar shumën e paguar, viti i marrjes së kredisë dhe kohëzgjatja e saj, si dhe data e fillimit të shlyerjes së kredisë dhe kësti mujor i pagesës.

14. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit, konstaton si vijon:

14.1. Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹³, motra e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, znj. S. J., kategorizohet si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të deklaramentit në cilësinë e dhurueses dhe huadhënëses. Konkretisht, nën dritën e dhurimeve të deklaruara të kryera në vitet 2010-2012, ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së saj, si dhe huave të dhëna kësaj të fundit, për mbulimin e shpenzimeve të studimit në periudhën 2012 – 2016, znj. S. J. ka marrë cilësinë e personit tjetër të lidhur. Nën dritën e të njëjtës dispozite, nga Komisioni u krye analiza financiare në drejtim të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve, nga e cila rezultoi se znj. S. J. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të financuar secilin prej veprimeve të sipërcituara, sikurse edhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës së personit të lidhur me subjektin, vajzës, gjatë studimeve të saj në Kanada.

14.2. Komisioneri Publik në ankim ka konstatuar se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhurimin e bërë nga znj. S. J., në shumën 3.500 CAD, në favor të së bijës, si dhe dhurimin në shumën 2.970,76 CAD, në favor të bashkëshortit të subjektit, të dy dhurime të bëra në vitin 2012.

14.2.1. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë të vitit 2010, 2011 dhe 2012 ka deklaruar në rubrikën rezervuar për të dhënat konfidenciale, përkatësisht për secilin vit: (i) 2.000 dollarë kanadezë nga znj. S. J.; (ii) 3.000 dollarë kanadezë, nga znj. S. J.; (iii) 2.970,76 dollarë kanadezë, nga S. J., tërhequr më datë 07.07.2012 nga llogaria bankare në CAD në emër të A. H. pranë “Raiffeisen Bank” ShA; (iv) në deklaratën e interesave privatë të vitit 2012, e bija S. H. ka deklaruar transfertën në Bankën TD [Canada Trust] më datë 7 shtator 2012, me burim “Dhuratë nga halla 2.000 dollarë”, si dhe transfertë në Bankën TD [Canada Trust] më datë 11 shtator 2012, po ashtu me burim “dhuratë nga halla 1.500 dollarë”. Subjekti rezulton që në përgjigjet e pyetësorit standard të ketë deklaruar shumat e dhëna të bijës, si dhuratë për fillimin e studimeve të larta. Në këto vite anëtarët e familjes së subjektit të rivlerësimit kanë përfituar në total 11.500 CAD [dollarë kanadezë] dhuratë nga S. J.. Po ashtu, në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar në rubrikën dedikuar përshkrimi të të ardhurave, *dhuratë nga motra* në vlerën 4.941 CAD, si dhe ka specifikuar tërheqjen nga llogaria bankare përkatëse në datat 29.12.2010 dhe 19.07.2011. Në këtë deklaratë nuk rezultojnë të jenë deklaruar dhuratat e vitit 2012, konkretisht shuma 2.970,76 CAD dhuruar të vëllait A. H. dhe 3.500 CAD dhuruar të mbesës S. H..

14.2.2. Referuar informacionit të dërguar Komisionit nga “Raiffeisen Bank” ShA, më datë 27.02.2019, dhurimet janë kryer nëpërmjet transfertave bankare në llogarinë e personit të lidhur në monedhën *dollarë kanadezë*, përkatësisht në datat 24.12.2010, 06.06.2011 dhe

¹³ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

04.07.2012, në vlerat që në total shkojnë 7.911,14 CAD¹⁴. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së personit të lidhur, znj. S. H., në Bankën TD [Canada Trust], rezulton se në këtë llogari janë transferuar shumat 2.000 dollarë kanadezë dhe 1.500 dollarë kanadezë, respektivisht në datat 07.09.2012 dhe 11.09.2012.

14.2.3. Në kuadër të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto dhurime në përgjigje të pyetësorit standard [datë 04.03.2019] dhe në parashtrimet në Kolegj ka sqaruar se shumat e dhuruara janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore, kanë kaluar në llogaritë nëpërmjet transfertës bankare, kanë burim të ardhurat e ligjshme nga punësimi i bashkëshortëve J. dhe mosdeklarimi i tyre në deklaratën e pasurisë *vetting* është një pakujdesi e subjektit të rivlerësimit, një harresë, pa pasur qëllim fshehjen e kësaj të ardhure të ligjshme.

14.2.4. Trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si dhe Komisioni, e vlerësoi mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* të dhurimeve një pasaktësi, nën dritën e përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur dhurimet e shumave monetare nuk përfshihen në të ardhurat e tatueshme të përcaktuara në nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ato u përlllogaritën si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit në vitet respektive. Këto shuma monetare të dhuruara janë përlllogaritur, gjithashtu, edhe në analizën financiare të kryer për të verifikuar mundësinë e znj. S. J. dhe anëtarëve të tjerë të familjes së saj, për krijimin e shumave të dhuruara apo dhënë hua mbesës, sipas përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të trajtuar në paragrafët 14.10 dhe 14.11 të këtij vendimi. Në kushtet kur pasaktësia në deklarim nuk u shoqërua me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të dhurueses S. J., ky fakt nuk u vlerësua shkak për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

14.3. Për sa i përket huave të dhëna nga personi tjetër i lidhur [znj. S. J.] personit të lidhur me subjektin [vajzës, S. H.], për të paguar pagesat për studimet, trupi gjykues konstaton sa vijon:

14.3.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar huan për shkollim nga halla, znj. S. J. dhe adresën e banimit të kësaj të fundit. Personi i lidhur po ashtu ka specifikuar që pagesa është kryer nëpërmjet bankës, në llogarinë e universitetit. Burim i deklaruar janë të ardhurat nga punësimi i znj. S. J.. Deklaruesja referon edhe dokumentacion bashkëlidhur për punësimin dhe huan.

14.3.2. Nga aktet në fashikull rezulton se personi i lidhur me subjektin, znj. S. H., është pranuar për të ndjekur programin e studimit 4-vjeçar “*Bachelor of Science in Engineering*”, në Universitetin e Albertës, Kanada, në vitin akademik 2012-2013. Tarifat e shkollimit [*tuition fees*] janë referuar përparësisht në vlerën 24.000 \$¹⁵, pa përfshirë shpenzimet për librat, furnizimet dhe shpenzimet e jetesës. Po ashtu, nga komunikimi shkresor i universitetit, më datë 29.08.2012, rezulton që S. H. është përfituese e një burse nga universiteti, si një nga aplikantët ndërkombëtarë më të mirë, që ka demonstruar ekselencë akademike, në sajë të së cilës do të përfitojë gjatë studimeve të saj 4-vjeçare një bursë prej 16.000 \$¹⁶.

14.3.3. Më tej, aktet në fashikull tregojnë që tarifatat e shkollimit¹⁷, duke zbritur bursën e

¹⁴ Më datë 24.12.2010, në shumën 1.970,40 CAD, më datë 06.06.2011, në shumën 2.969,95 CAD dhe më datë 04.07.2012, shumën 2.970,76 CAD.

¹⁵ Simboli “\$” në përmbajtje të këtij vendimi, i referohet monedhës “dollar kanadezë” [CAD], lehtësisht e verifikueshme me aktet në fashikullin gjyqësor.

¹⁶ Përkatësisht, 9.000 \$ në vitin e parë të studimeve, 3.000 \$ në vitin e dytë, 2.000 \$ në vitin e tretë dhe 2.000 \$ në vitin e katërt.

¹⁷ Sipas faturave të pagesave [Payment receipt] të zyrës “Financial Services – Student Receivables” të Universitetit të Albertas, Kanada, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, datë 23.04.2020.

përfiturar në vitet akademike 2012-2016, financuar nga S. J. në formë huaje, rezultojnë në shumën 93.375,48 CAD¹⁸. Kjo marrëdhënie detyrimi është formalizuar në aktmarrëveshjet të nënshkruara nga huadhënësja S. J. dhe huamarrësja S. H., përkatësisht: më datë 10.09.2012, për shumën 11.487,92 \$; më datë 02.01.2013, për shumën 13.552, 27 \$; më datë 05.01.2014, për shumën 28.405,4 \$; më datë 02.01.2015, për shumën 27.577, 35 \$; dhe më datë 05.01.2016, për shumën 12.754,14 \$. Me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktmarrëveshjet, në të cilat përcaktohet qëllimi i dhënies së huas mes palëve dhe marrëdhënien mes tyre dhe që pagesa do të kryhet direkt e në llogarinë bankare të universitetit. Huaja është dhënë pa interes dhe detyrimi i kthimit nis kur huamarrësja të fillojë punë, në këste të cilat do të jenë 10 % të pagës së saj mujore, deri në shlyerjen e plotë. Pagesat janë kryer sipas specifikimeve¹⁹ në dokumentet e lëvizjeve të llogarive bankare. Aktmarrëveshja e datës 02.01.2013 rezulton e depozituar pranë ILDKPKI²⁰-së përpara procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit për këtë subjekt deklarues. Huat e marra janë deklaruar rregullisht në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, në deklaratat e interesave privatë periodikë 2012-2016, nga S. H..

14.4. Siç u referua më sipër, për shkak të cilësimit të znj. S. J., si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit dokumentacion lidhur me: (i) momentin kohor kur kanë shkuar në Kanada S. J. dhe familja e saj; (ii) shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të S. J. për periudhën 2010 e në vijim; (iii) lëvizjet në llogaritë bankare të bashkëshortëve S. dhe Z. J. për këtë periudhë; (iv) të ardhurat e familjes J., që kanë shërbyer si burim i ligjshëm për huan, dhuratat dhe shpenzimet e jetesës në Kanada; (v) pasuritë e luajtshme/palujtshme të bashkëshortëve J. në Kanada apo Shqipëri, pas vitit 2010, informacion mbi burimin e krijimit të tyre, informacione të tjera, mbi detyrimet [qira/kredi/garanci], si dhe për qëndrimin apo shtetësinë e tyre në Kanada.

14.4.1. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar po ashtu edhe që znj. S. J. dhe familja e saj kanë shkuar në Kanada që në fund të vitit 2002 dhe tashmë janë shtetas kanadezë. Të dy djemtë e familjes janë diplomuar po ashtu në Universitetin e Albertas dhe janë punësuar menjëherë pas diplomimit. Njëri prej tyre ka punuar dhe jeton në qytet tjetër nga prindërit. Znj. S. J. nuk ka shpenzuar për shkollimin e tyre, ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit, pasi shpenzimet e studimit për studentët vendas janë shumë më të ulta krahasuar me studentët e huaj, si dhe shteti kanadez ofron hua studentore, përpos që fëmijët e saj kanë punuar gjatë periudhës së studimeve. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pagesat e tarifave të studimit të hartuar nga zyra përgjegjëse e Universitetit të Albertas, për të dy fëmijët e personit tjetër të lidhur për periudhën 2009-2013.

14.4.2. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar që znj. S. J. e bashkëshorti nuk kanë blerë pasuri të luajtshme/palujtshme, në Kanada, pas vitit 2010, ndërsa në Shqipëri kanë blerë apartament dhe automjet. Në këtë kontekst, apartamenti²¹ i blerë prej tyre në vitin 2012 në vlerën 75.707 euro është shlyer në rrugë bankare. Pagesat janë kryer në llogarinë bankare të

¹⁸ Pagesat për semestrat: 1. Vjeshtë 2012, shuma 7.102,92 CAD; 2. Dimër 2013, shuma 6.808, 40 CAD; 3. Vjeshtë 2013, shuma 12.727, 27 CAD; 4. Dimër 2014, shuma 13.480,83 CAD; 5. Vjeshtë 2014, shuma 14.924,57 CAD; 6. Dimër 2015, shuma 14.841,07 CAD; 7. Vjeshtë 2015, shuma 12.736,28 CAD; 8. Dimër 2016, shuma 12.754,14 CAD.

¹⁹ Nëpërmjet llogarive bankare të znj. S. J., në TD Canada Trust, në llogarinë e Universitetit të Alberta për S. H., në 10 transhe, në datat dhe shumat si vijon: (i) më 11.09.2012, shuma 11.487,92 \$; (ii) më 3.01.2013, shuma 1.000 \$; (iii) më 21.09.2013, shuma 8.552,27 \$; (iv) më 15.09.2013, shuma 4.000 \$; (v) më 25.01.2014, shuma 13.480,83 \$; (vi) më 20.09.2014, shuma 14.924,57 \$; (vii) më 21.01.2015, shuma 14.841,07 \$; (viii) më 24.09.2015, shuma 12.736,28 \$; (ix) më 16.01.2016, shuma 5.000 \$; (x) më 16.01.2016, shuma 7.754,14 \$.

²⁰ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 27.04.2020, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit.

²¹ Porositur më datë 13.7.2010 dhe blerë me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 15.08.2012.

shoqërisë shitëse [***] ShPK], në tre këste²². Po ashtu, bashkëshorti i personit tjetër të lidhur rezulton të ketë blerë automjet në vlerën 6.000 euro me kontratë shitblerje automjeti²³, më datë 12.08.2016.

14.4.3. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se burimi i këtyre pasurive janë të ardhurat familjare. Bashkëshortët J., sipas shpjegimeve të subjektit, qëndrojnë në Shqipëri gjatë periudhës së verës, pasi kryejnë punë që u lejon pushime të paguara. Ky fakt provohet dhe nga të dhënat e sistemit *TIMS* të administruara nga Komisioni në dosjen gjyqësore, nga të cilat këta dy individë rezultojnë të kenë qëndruar për periudha të gjata një mujore e më shumë gjatë verës në disa vite²⁴. Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi si të pabazuar argumentimin e ngritur nga Komisioneri për arsyet e mbajtjes së llogarisë bankare të familjes J., në Shqipëri, edhe pas vitit 2002. Subjekti i rivlerësimit solli në vëmendje mungesën e pengesave ligjore për këta dy individë, shtetas shqiptarë, për të krijuar dhe mbajtur llogari bankare në Shqipëri.

14.4.4. Komisioneri Publik ka konstatuar që Komisioni nuk ka administruar lëvizjet e llogarive bankare të personave të tjerë të lidhur (familja J.), në Shqipëri dhe Kanada. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për lëvizjet e llogarive bankare të çiftit J. [në Shqipëri dhe Kanada] për periudhën 2010 në vijim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se marrja e këtij informacioni voluminoz, për nga natyra, kërkon kohë. Po ashtu, shpenzimet kryhen me kartë krediti dhe përbëjnë informacion shumë privat e me të dhëna shumë konfidenciale. Me parashtrimet në Kolegj, më datë 02.09.2022, subjekti i rivlerësimit depozitoi nxjerrjet e llogarive bankare të z. J., në monedhën euro dhe dollar kanadezë [CAD], nga “Raiffeisen Bank” ShA. Nga lëvizjet e këtyre llogarive bankare, parashtrori subjekti i rivlerësimit, rezulton qartë që llogaritë bankare nga familja J. në “Raiffeisen Bank” ShA janë çelur në korrik 2010, me qëllim transferimin e shumave në rrugë bankare dhe kryerjen e pagesave në favor të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, për shlyerjen e vlerës së apartamentit, çka vërteton qëllimin e çeljes së tyre.

14.4.5. Nga analiza e lëvizjeve të këtyre llogarive bankare, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nga llogaria bankare në CAD nuk janë kryer transaksione të tjera, deri në mbylljen e saj në muajin korrik 2010, ndërsa llogaria në EUR vetëm është debituar me shumën e komisioneve bankare për mirëmbajtje llogarie, deri në mbylljen e saj në gusht 2019. Këto të dhëna, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, provojnë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se këto llogari janë çelur vetëm për likuidimin e vlerës së apartamentit.

14.5. Subjekti ka deklaruar se familja J. jeton në shtëpinë e blerë nëpërmjet kredisë bankare²⁵. Në ankim, Komisioneri Publik ka pretenduar se për investimin e kryer për këtë pasuri nuk rezulton të jetë hetuar vlera totale dhe viti i investimit, sipas dokumentacionit të fitimit të pasurisë. Nga aktet e administruara, argumentoi Komisioneri Publik, mbetet e paqartë: (i) nëse vlera totale e këtij aseti është financuar tërësisht nga kredia bankare apo janë përdorur dhe kursimet e familjes për të mbuluar shumën e paguar; (ii) viti i marrjes së kredisë dhe kohëzgjatja e saj; si dhe (iii) data e fillimit të shlyerjes së kredisë dhe kësti mujor i pagesës.

14.5.1. Në kundërankim, subjekti i rivlerësimit ka referuar përgjigjet e pyetësorit të datës 23.04.2020, në të cilat ka sqaruar se çifti J. nuk ka blerë pasuri të paluajtshme pas vitit 2010, kohë që përkon me huat dhe dhurimet e tyre në favor të personave të lidhur me subjektin e

²² Referuar dokumentit bankar të “Raiffeisen Bank” ShA, dokumentohen pagesat: më datë 13.07.2010, shuma 1.000 euro; më datë 19.07.2010 shuma 70.000 euro dhe shuma 921.9 euro; si dhe më datë 31.07.2012, shuma 3.785 euro.

²³ Kontratë shitblerje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.08.2016.

²⁴ Referuar të dhënave *TIMS*, për znj. S. J. rezultojnë hyrje-dalje për çdo vit, në vitet 2010-2019, ndërsa për bashkëshortin e saj duke filluar nga viti 2012-2019.

²⁵ Me adresë {***}, {***}, {***}, Kanada.

rivlerësimit. Subjekti ka sjellë në vëmendje që shtëpia në Kanada është blerë në vitin 2006 me burim financimi kredi bankare 6 (gjashtë) vjet përpara se të fillonte marrëdhënia e huas. Këto shpjegime u parashtruan sërish në procesin gjyqësor në Kolegj. Së bashku me parashtrimet, subjekti ka paraqitur edhe akte shkresore të cilat u administruan në cilësinë e provës me vendim të ndërmjetëm, marrë gjatë seancës gjyqësore të datës 13.09.2022. Këto prova konsistojnë në: (i) kontratë blerje prone të paluajtshme [mes shitëses E. O. dhe blerësve Z. dhe S. J.], datë 01.05.2006; (ii) kopje e certifikuar e dokumentit të pronësisë mbi banesën me vendndodhje në {***}, Kanada, në emër të Z. J. dhe S. J., datë 17.05.2003; (iii) konfirmim për pagesat e kredisë hipotekare lëshuar nga Scotiabank, më datë 18.05.2006.

14.5.2. Referuar këtyre akteve që datojnë në vitin 2006, vlera e shtëpisë në Kanada është 246.500 \$. Në këtë shumë, 3.000 \$ është depozituar me nënshkrimin e kontratës, ndërsa shuma 243.500 \$ nëpërmjet kredisë bankare hipotekare, me afat 25 vjet dhe këst mujor 1.002,78 \$.

14.6. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe dokumentacion mbi të ardhurat nga punësimi i anëtarëve të familjes J. [bashkëshortëve J. dhe djemve], sipas deklaratave të të ardhurave individuale [*Notice of assessment*] të lëshuara nga Agjencia Kanadeze e Deklarimit të të Ardhurave [*Canada Revenue Agency*] për periudhën 2010-2018 dhe dy vërtetime page [*Salary/Employment Verification*]²⁶ për S. J. dhe dokument pagese për Z. J.²⁷. Ndërsa me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti rezulton të ketë depozituar fletëpagesa të lëshuara nga {***}, për muajt dhjetor të viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015, si dhe muajin shtator të vitit 2016, lëshuar për S. J., e punësuar si mësuese, asistente dhe teknike laboratorit pranë këtij institucioni.

14.7. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e bija është akomoduar në banesën e hallës gjatë periudhës së studimeve – në adresën e sipër referuar – dhe shpenzimet jetike për këtë periudhë, shtator 2012 – maj 2016, janë përballuar nga halla dhe familjarët e saj, si dhe të ardhurat e të bijës²⁸ nga puna *part-time* gjatë vitit dhe muajve të pushimeve. Personi i lidhur, S. H., rezulton të ketë deklaruar si adresë banimi në deklaratë e interesave privatë periodikë 2012 deri më 2019 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, adresën e banesës së familjes J., në Kanada. Të njëjtën adresë banimi rezulton të ketë deklaruar edhe në korrespondencën me bankat në Kanada dhe me institucionet e tjera të këtij vendi. Komisioneri Publik ka pretenduar se nëse huas për shpenzimet e studimeve do t'i shtohet edhe mbështetja financiare, nëpërmjet mbulimit të shpenzimeve të jetesës të personit tjetër të lidhur me subjektin [vajzës] për vitet 2012-2016, kontributi i familjes J. do të pësonte rritje me rreth 50.000 CAD.

14.8. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se përbërja e familjes J., për efekt të shpenzimeve të jetesës, nga Komisioni është konsideruar e njëjtë – për një familje me katër anëtarë – pasi ka marrë në konsideratë faktin që, ndërsa një prej djemve është larguar në vitin 2011 në tjetër qytet pas diplomimit, personi i lidhur me subjektin rezulton të jetë vendosur në Kanada vetëm duke filluar nga vjeshta 2012. Për pasojë, shpenzimet jetike të familjes J. mbeten të pandryshuara. Në kushtet kur S. H. rezulton të ketë jetuar me familjen e hallës, duke filluar nga shtatori 2012 deri në maj 2016 dhe shpenzimet jetike i janë mbuluar nga anëtarët e kësaj familje në këtë periudhë, qasja e Komisionit është e bazuar. Duke e konsideruar personin e lidhur S. H., si një ndër katër personat për të cilët është përlllogaritur shpenzim jetese në ngarkim të

²⁶ Lëshuar nga {***}, më datë 01.05.2019, sipas të cilit S. J. ka qenë e punësuar me kohë të plotë si mësuese, me kontratë të vazhdueshme prej datës 30.08.2005 dhe pagë vjetore 56.770 \$, si dhe dokument pagese lëshuar nga {***}.

²⁷ Lëshuar nga Universiteti i Athabasca, Kanada.

²⁸ Në pyetësorin standard, datë 04.03.2019. Faktet e referuara për pagesat nga punësimet e pjesshme të personit të lidhur provohen dhe nga lëvizjet e llogarisë bankare të S. H., në TD Canada Trust.

bashkëshortëve J. për periudhën shtator 2012 – maj 2016, pretendimi për kontribut shtesë prej personit tjetër të lidhur në funksion të analizës financiare, pretenduar nga Komisioneri Publik, është për pasojë i pabazuar.

14.9. Pas analizimit të akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit më datë 02.09.2022, në parashtrimet përfundimtare në Kolegj, Komisionerja Publike solli në vëmendje që investimi për shtëpinë në Kanada nga familja J. është kryer disa vite përpara se të fillonte marrëdhënia e huas dhe dhurimit me personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, kredia për shtëpinë e marrë nga familja J. në Kanada dhe këstet mujore të paguara në funksion të shlyerjes së saj²⁹ nuk ndikon në aftësinë financiare të tyre për të mbuluar huat dhe dhurimet. Po ashtu, sipas Komisioneres Publike, të dhënat që rezultojnë nga llogaritë bankare të z. J. në “Raiffeisen Bank” ShA, tregojnë përdorimin për transaksionin e shitblerjes së apartamentit në Tiranë, në shumën rreth 75.000 euro, ndërsa për periudhën 2010 – 2016, në llogaritë në fjalë nuk ka pasur kursime në vlera domethënëse. Në përfundim të sa më sipër, Komisionerja Publike u shpreh se nuk u konstatuan rrethana të tilla faktike që do të çonin në një vlerësim të ndryshëm nga ai i arritur nga Komisioni, lidhur me aftësinë e familjes J., për të mbuluar me të ardhura nga burime të ligjshme huat dhe dhurimet e kryera në favor të familjes së subjektit të rivlerësimit.

14.10. Trupi gjykues i Kolegjit kreu analizën për të verifikuar mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. J., për të justifikuar me të ardhura të ligjshme, dhurimet dhe huat e dhëna për periudhën 2010-2016, të cilat në total arrijnë vlerën 105.452 dollarë kanadezë. Ndryshe nga analiza financiare e paraqitur në paragrafin 35.2.1.2.4, faqe 17 e vendimit të Komisionit, në linjë me analizën paraprake të Komisionit, pjesë e fashikullit gjyqësor, në Kolegj u krye analiza financiare për periudhën 2009-2016, duke mbajtur në konsideratë që dhurimi i parë i znj. S. J. për vëllanë [personin e lidhur me subjektin] daton më 24.12.2010. Analiza financiare e kryer në Kolegj u shtri prej fillimit të vitit 2009, për disa arsye. *Së pari*, nga dokumentacioni i administruar, znj. S. J. ka qenë e punësuar pranë {***} prej gushtit të vitit 2005, pa ndërprerje dhe *së dyti*, në vitin 2010, kur është dhënë dhurimi i parë në shumën 2.000 dollarë kanadezë, familja J. ka blerë apartamentin në Tiranë në vlerën 71.921 euro në datën 19.07.2010. Me arsyetimin se bashkëshortët J. kanë qenë në marrëdhënie pune në vijimësi është vlerësuar të përlllogaritet mundësia e tyre për kursim prej vitit 2009, si dhe të aplikohet metodologjia e kursimeve të akumuluar të familjes J. për periudhën 2009-maj 2016, duke konsideruar, në mungesë të dokumentacionit, të ardhurat dhe shpenzimet të njëjta me ato të vitit 2010.

14.11. Në këtë analizë u përfshinë të dhënat e ekstraktuara nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore. Ndryshe nga Komisioni, në analizën financiare të kryer në Kolegj, u konsideruan të ardhurat *neto* nga pagat sipas deklaramit³⁰ për efekt të taksave pranë autoriteteve kanadeze për anëtarët e familjes J. të cilat u përlllogaritën, duke zbritur taksat në masën 30%. Në shpenzime u përfshinë shpenzimet e jetesës, të cilat në linjë me Komisionin u përlllogaritën për një familje (*household*), sipas Anketës së Buxhetit të Familjes të publikuar nga Zyra e Statistikave të Kanadasë³¹. U përlllogaritën, gjithashtu, dhuratat për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit në shumat 2.000 CAD në vitin 2010, 3.000 CAD në vitin 2011 dhe 6.500 CAD në vitin 2012, transferuar nëpërmjet “Raiffeisen Bank” ShA dhe TD Canada Trust, tarifat e studimit për djemtë e personit tjetër të lidhur, sipas dokumentacionit lëshuar nga Universiteti i Albertës. Gjithashtu, në shpenzimet e familjes J. u përfshinë edhe shpenzimet për udhëtimin e personit të lidhur me subjektin, S. H., në korrik-gusht të vitit 2011 [shih paragrafin 19.9 të këtij vendimi]. Së fundmi, në këtë analizë u përfshinë investimet³² nga familja J. në Shqipëri dhe,

²⁹ Këstet në vlerën 1.002,78 CAD.

³⁰ Deklarim vjetor të të ardhurave individuale kryer në adresë të Agjencisë Kanadeze e Deklarimit të të Ardhurave.

³¹ Household spending, Canada, regions and provinces (statcan.gc.ca)

<https://www150.statcan.gc.ca/t1/tbl1/en/tv.action?pid=1110022201&cubeTimeFrame.startYear=2010&cubeTimeFrame.endYear=2019&referencePeriods=20100101%2C20190101>

³² Përkatësisht, në vlerën 75.707 euro dhe 6.000 euro.

konkretisht, për blerjen e apartamentit në Tiranë, likuiduar në vitin 2010 dhe 2012, si dhe për blerjen e një automjeti në datën 12.08.2016. Sa i përket shtëpisë së blerë në Kanada në vitin 2006, në analizë u përfshi kësti mujor në vlerën 1.016 dollarë kanadezë, si dhe huat dhënë së mbesës në periudhën 2012-2016. Në përmbledhje, nga analiza financiare rezulton se personi tjetër i lidhur dhe familja e saj kanë pasur të ardhura financiare të ligjshme të mjaftueshme për dhurimet dhe huat në favor të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

14.12. Komisioneri Publik në ankim ka lidhur gjendjen e kursimeve/depozitave në bankë të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, me mundësinë financiare të familjes J. për t'i dhënë hua për studim personit të lidhur S. H.. Ky pretendim rezulton i paarsyetuar në ankimin e Komisionerit Publik. Në përgjigjen e dhënë gjatë seancës gjyqësore të datës 13.09.2022, subjekti i rivlerësimit sqaroi se ndonëse kishte pasur gjendje likuiditeti të konsiderueshme në llogari bankare për të mundësuar financimin e studimeve, për të cilat nuk ka përballuar shpenzime pasi e bija ka marrë hua për shkollimin, ka qenë dëshira e hallës dhe familjarëve të saj që vajza e saj të studiojë në Kanada me ndihmën e tyre. Huaja është marrë nga e bija, parashtrori subjekti, është deklaruar në të gjitha deklaratat periodike vjetore e në atë *vetting*, është transferuar direkt në llogarinë e universitetit dhe transaksionet janë kryer nëpërmjet sistemit bankar. Subjekti i rivlerësimit është kujdesur për prindërit e bashkëshortit, fakt për të cilin halla e vajzës ka qenë mirënjohëse dhe, për rrjedhojë, e prirur të ndihmojë familjen e subjektit të rivlerësimit.

- 15.** Lidhur me shlyerjen e huas në vitin 2016 dhe gjendjen e detyrimit të mbetur pashlyer nga personi i lidhur kundrejt hallës, Komisioneri Publik konstatoi mospërputhje të detyrimit të mbetur pashlyer deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, krahasuar me atë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016. Referuar detyrimit të deklaruar në deklaratat interesave privatë të vitit 2016 dhe 2017, deri në fund të vitit 2017 rezulton të jenë shlyer 34.706,22 CAD, nga të cilët, 9.600 CAD gjatë vitit 2017 dhe diferenca në vlerën 25.106,22 CAD të jetë shlyer deri në fund të vitit 2016. Ndërkohë, personi i lidhur ka deklaruar se gjatë vitit 2016 ka shlyer shumën 13.775,48 CAD. Kjo shumë u konfirmua edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Sipas Komisionerit Publik mbetet e paqartë shuma e detyrimit të shlyer nga personi i lidhur huadhënëses deri në datën 31.12.2016.

15.1. Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore dhe asaj të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se personi i lidhur ka deklaruar sa vijon:

15.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, hua për arsimim pranë Universitetit të Albertës gjatë periudhës shtator 2012-prill 2016. Shuma e detyrimit financiar e mbetur pa shlyer 81.600 CAD.

15.1.2. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, nga huaja e marrë, deri më datë 31 dhjetor të vitit 2016, shlyer shuma 13.775,48 CAD dhe gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer 68.845,86 CAD.

15.1.3. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017, shuma e shlyer nga huaja 9.600 CAD dhe gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer 59.245,86 CAD.

15.2. Në kundërankim dhe në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mospërputhja në deklarimin e detyrimit të mbetur pashlyer nga huaja ka ardhur si rezultat i periudhave të ndryshme të dorëzimit të deklaratave, konkretisht: deklarata e pasurisë *vetting*, mban datën janar 2017, ndërsa deklarata e interesave privatë të vitit 2016, mban datën mars 2017. Për këtë arsye, në deklaratën periodike të dorëzuar në mars 2017 [për vitin 2016], rezulton të jetë zbritur dy herë shuma e shlyer deri në fund të vitit 2016, duke konsideruar si deklaratë të fundit, deklaratën e pasurisë *vetting*. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se gabimisht, gjendjen e huas së mbetur pashlyer në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, personi i lidhur e ka zbritur nga vlera 81.600 CAD e deklaruar si detyrim i mbetur pashlyer në

deklaratën e pasurisë *vetting*. Ky gabim është mbartur më pas edhe në deklaratën e interesave privatë të vitit 2017. Pasi është konstatuar, gabimi është ndrequr në deklaratat e interesave privatë të vitit 2018 dhe 2019, në të cilët është deklaruar saktë vlera e detyrimit financiar i mbetur pa shlyer znj. S. J..

15.3. Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe deklaratat e interesave privatë të vitit 2018 dhe 2019³³ në të cilat personi i lidhur [vajza] ka deklaruar si vijon:

15.3.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2018, shuma e shlyer nga detyrimi i mëparshëm 14.500 CAD, dhe gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer 57.500 dollarë kanadezë.

15.3.2. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2019, shuma e shlyer nga detyrimi i mëparshëm 15.600 CAD, dhe gjendja e detyrimit të mbetur pashlyer 41.900 CAD.

15.4. Në parashtrimet përfundimtare, Komisionerja Publike u shpreh se pretendimi i subjektit të rivlerësimit qëndron dhe detyrimi i mbetur në fund të viteve respektive rezulton se është korrigjuar. Trupi gjykues i Kolegjit ndan të njëjtin vlerësim si edhe Komisionerja Publike në parashtrimet përfundimtare. Në analizë të akteve në fashikull të sipërcituara, pretendimeve të Komisioneres Publike dhe atyre të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se mospërputhja është rezultat i një gabimi material në deklarimin e vitit 2016, për shkak të një veprimi të gabuar aritmetikor.

16. Në ankim, Komisioneri Publik, po ashtu pretendon se dokumentacioni bankar i personit të lidhur, ndryshe nga sa deklarohet në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, nuk rezulton që personi i lidhur të ketë kryer pagesa nga llogaria e saj në Kanada në favor të personit tjetër të lidhur, znj. J. gjatë vitit 2016. Personi i lidhur ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi për vitin 2016 rezulton në pamundësi financiare për të shlyer huan prej 13.775,48 CAD znj. J. me të ardhurat e realizuara gjatë vitit në fjalë. Konkretisht, personi i lidhur gjatë vitit 2016, ka përfituar të ardhura prej rreth 53.000 CAD, ka krijuar kursime në vlerën prej 27.000 CAD në llogaritë bankare, ndërsa diferenca e mbetur ka shërbyer për shpenzime/pagesa të kryera nëpërmjet llogarisë së saj bankare.

17. Nga aktet rezulton që në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur deklaroi se huaja ka filluar të shlyhet pasi ajo është punësuar, nga data 9 maj 2016. Në kundërankim dhe në parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendon se nga lëvizjet e llogarisë bankare deri në datën 31.12.2016 rezulton që personi i lidhur [e bija] të ketë shlyer shumën 13.775,48 CAD nga huaja nëpërmjet *e-transfer* tek znj. J. në datat 12.08.2016, 26.09.2016 dhe 28.11.2016 dhe nëpërmjet transfertës në llogarinë e djalit të saj L. J. [***]. Subjekti parashtrori edhe një listë transaksionesh të cilat, sipas saj, provojnë kohën dhe shumën e pagesës respektive, në harkun kohor nga qershori deri në nëntor 2016, në vlerën 13.690,7 CAD.

17.1. Për të provuar këtë pretendim, me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar tri akte në cilësinë e provës, e konkretisht një deklaratë noteriale të lëshuar nga personi tjetër i lidhur në datën 20.08.2022 dhe dy kopje të dokumentacionit bankar të personit të lidhur, nga llogaria e saj në Kanada, në të cilat provohen transfertat që lidhen me huat. Sipas deklaratës noteriale të lëshuar nga znj. J., mbesa e saj, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, ka shlyer 13.775, 48 CAD në vitin 2016 nëpërmjet transaksioneve bankare. Dy aktet e tjera, nxjerrje llogarish bankare të personit të lidhur në TD Canada Trust, që provojnë transfertat nga personi i lidhur te halla dhe djali i saj për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2016, në total 15.808,64 CAD dhe një transfertë bankare në shumën 4.400 CAD.

17.2. Lidhur me aktet e sipërcituara, në parashtrimet përfundimtare, Komisionerja Publike u shpreh se dokumentet bankare i përkasin periudhës nga 01.01.2015 -- 31.12.2016, ndërkohë që

³³ Përcjellë subjektit nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. [***] prot., datë 30.08.2022.

në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016 dhe gjatë hetimit administrativ shlyerja e huas është deklaruar të ketë filluar nga muaji maj 2016. Përveçse nuk korrespondojnë me shumën e deklaruar, disa prej transfertave janë kryer para fillimit të punës në maj 2016, nga ku duket se nuk lidhen me shlyerjet e huas. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shumat e kaluara në favor të djalit të personit të lidhur, z. L. J., kanë shërbyer për shlyerjen e huas së deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, në vlerësim të Komisionerit Publik mbeten në nivel deklarativ, pasi nuk provohen nga aktet e administruara. Subjekti i rivlerësimit, sipas Komisioneres Publike, arriti të dokumentojë vetëm pagesën 4.400 CAD në favor të huadhënëses [znj. J.], fakt që redukton pamjaftueshmërinë e konstatuar për shlyerjen e detyrimit në vitin 2016 nga 13.775,48 CAD në 9.375,48 CAD ose rreth 890.000 lekë.

17.3. Në analizë të këtij shkaku të ankimit, që lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm të personit të lidhur S. H., trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare për vitin 2016, për të verifikuar mundësinë financiare të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, për të shlyer në këtë vit pjesën e huas në shumën 13.775,48 CAD. Të dhënat në analizën financiare u ekstraktuan nga dokumentacioni justifikues ligjor i administruar në dosjen gjyqësore.

17.3.1. Në të ardhura u përllogaritën: (i) bursat e akorduara nga Universiteti i Albertës, Kanada, për dy fëmijët e subjektit të rivlerësimit; (ii) të ardhurat e vajzës nga puna³⁴ duke filluar nga data 09 maj 2016 - 31 dhjetor 2016; (iii) të ardhura nga punësimi i mëparshëm, ekstraktuar nga lëvizjet e llogarisë bankare në një bankë kanadeze; (iv) taksa të rimbursueshme të ekstraktuara nga deklarimi vjetor i të ardhurave individuale për efekt të detyrimeve ndaj autoriteteve të taksave në Kanada; (v) pagesa nga punëdhënësi për aksione dhe kontribute nëpërmjet platformës “Solium”, sipas nxjerrjes së llogarisë për vitin 2016 [duke filluar nga 31.05.2016]; (vi) pagesa nga prindërit sipas transfertës nëpërmjet llogarisë së bashkëshortit të subjektit [A. H. në Tirana Bank ShA], më datë 16.09.2016, në shumën 5.990,31 euro.

17.3.2. Në shpenzime u konsideruan: (i) shpenzimet e jetesës, prej muajit qershor 2016 e në vijim për personin e lidhur dhe duke filluar nga muaji shtator 2016 edhe për vëllanë, djalin e subjektit të rivlerësimit, duke marrë në konsideratë shpjegimin për këtë efekt të bërë nga subjekti³⁵. Këto shpenzime janë përllogaritur për një familje (*household*), sipas Anketës së Buxhetit të Familjes të publikuar nga Zyra e Statistikave të Kanadasë - shpenzimet e udhëtimit - shpenzimet e shkollimit për S. dhe O. H., sipas *dokument pagese* lëshuar nga Universiteti i Albertës, Zyra “*Financial Services – Student Receivables*”.

17.3.3. Në analizë u përllogaritën pasuritë - aksione pranë “Bird Construction Inc-T” - shuma e investuar në *Planin e Pensionit* paguar në masën 50 % nga S. H. dhe 50% nga punëdhënësi, marrë nga *statement i Planit të Pensioneve*, verifikuar me lëvizjen e llogarisë së pagës në bankën “TD Canada Trust” - ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve si diferencë mes gjendjes së llogarive bankare në fund të periudhës me atë në fillim.

17.3.4. Për shlyerjen e huas në shumën 13.775,48 dollarë kanadeze në vitin 2016, nga personi i lidhur S. H., kundrejt hallës së saj znj. S. J., rezultatet e analizës financiare treguan një mungesë burimesh financiare në shumën (-) 3.325 CAD, konvertuar në 312.610 lekë.

18. Lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro për blerjen e makinës “Ford Focus”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, Komisioneri Publik në analizë të

³⁴ Me detyrë inxhinieri mekanike pranë kompanisë NASON Contracting Industrial.

³⁵ Në pyetësorin e datës 23.04.2020, subjekti ka shpjeguar se personi i lidhur, znj. J. dhe bashkëshorti i saj ka mbështetur me mbulimin e shpenzimeve të jetesës vetëm vajzën e subjektit. Shpenzimet e jetesës për djalin janë mbuluar nga vajza dhe vetë djali, ka sqaruar subjekti i rivlerësimit.

mjaftueshmërisë financiare për periudhën 01.01.2011-19.07.2011, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë tërhequr *cash* nga llogaritë bankare në total 917.260 lekë, përfshirë këtu edhe shumën 2.971 CAD të dhuruar nga znj. S. J., ndërkohë që pagesa 7.000 euro dhe shpenzimet e tjera llogariten në shumën 1.304.351 lekë. Në këto kushte, subjekti dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën në shumën 7.000 euro, për një diferencë negative me së paku (-) 387.091 lekë.

19. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të këtij pretendimi, konstaton:

19.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *autoveturë* “Ford Focus” të përfituar me kontratë qiraje financiare, datë 25.07.2011, nga shoqëria “Tirana Leasing”, në vlerën 14.000 euro, nga të cilat 7.000 euro janë paguar nga kursimet e të ardhurave dhe 7.000 euro nga qiraja financiare me interes 8 % dhe afat shlyerje katër vjet. Detyrimi është shlyer dhe, për pasojë, me kontratë noteriale [datë 06.07.2015] automjeti ka kaluar në bashkëpronësi me bashkëshortin.

19.2. Nga kushtet e kontratës së qirasë financiare, në të cilën subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti janë në cilësinë e qiramarrësit dhe dokumenteve bankare shoqëruese të kësaj kontrate³⁶, rezulton se shuma 7.000 euro [parapagim] është paguar më datë 19.07.2011. Në deklarinimin për herë të parë të kësaj pasurie në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e shumës së parapaguar 7.000 euro.

19.3. Në kundërankim dhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi pretendimin e Komisionerit Publik me arsyetimin se nëse do të analizoheshin me kujdes të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur për periudhën 01.01-19.07.2011, të ardhurat e ligjshme rezultojnë në një shumë më të madhe se 1.304.351 lekë të llogaritur nga Komisioneri Publik, për pagesën e automjetit dhe shpenzime të tjera. Në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje aspektet si: gjendja e llogarive bankare dhe gjendja *cash* e të ardhurave të akumuluar nga vitet e mëparshme në vlerën 1.486.600 lekë, gjendje në datën 01.01.2011, si dhe dhurata në shumën 2.970,76 CAD, tërhequr në datën 19.07.2011. Po ashtu, subjekti parashtron se deklarimi në fund të vitit 2011 nuk mund të shërbejë si bazë për kryerjen e analizës financiare deri në datën 19.07.2011.

19.4. Në parashtrimet përfundimtare, Komisionerja Publike u shpreh se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e kursimeve *cash* në analizën e burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit në vitin 2011, nuk mund të pranohet pasi nuk bazohet në sa ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike të vitit 2011. Nën dritën e parashikimeve të nenit D, pika 1 dhe 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit, sjell në vëmendje që në kuadër të përmbushjes së objektit të kontrollit lidhur me kriterin e pasurisë, subjektet e rivlerësimit kërkohet të deklarojnë në deklaratën e pasurisë *vetting* çdo pasuri, sikurse edhe burimin e krijimit të tyre. Nga ana tjetër, rezulton se ndonëse subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e shumës 7.000 euro, në deklaratën interesave privatë të vitit 2011, këtë detyrim e ka përmbushur në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë deklaratë, subjekti për këtë pagesë ka deklaruar si burim “kursimet e të ardhurave”.

19.5. Trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga Komisioneri Publik që e mbështet analizën e mjaftueshmërisë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj në shumat e tërhequra *cash* nga llogaritë e tyre bankare në total 917.260 lekë - përfshirë edhe shumën 2.971 CAD të dhuruar nga znj. J. - dhe ndryshe nga analiza financiare e Komisionit në paragrafin 25.5 të vendimit objekt shqyrtimi, që shtrihet në të gjithë vitin 2011, mori në konsideratë periudhën 01.01.2011 -19.07.2011, kur është kryer pagesa 7.000 euro. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit pretendon se për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer gjendja e llogarive bankare dhe gjendja në *cash*

³⁶ Depozitë në arkë/cash depozitë pranë “Tirana Bank” ShA, përcjellë në Komision.

e të ardhurave të akumuluar nga vitet e mëparshme, gjendje më 01.01.2011, trupi gjykues analizoi deklaratat e interesave privatë të periudhës 2003 - 2011, në drejtim të gjendjes *cash* të deklaruar dhe konstatoi se:

- Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë në shumën 1.000.000 lekë, në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Nuk deklarohen kursime gjendje *cash* në banesë.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe mospagim qira banese, gjendje cash 600.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe depozita bankare. Gjendje cash 250.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, subjekti ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe depozitat bankare. Gjendje në cash 600.000 lekë*, ndërsa personi i lidhur [bashkëshorti] ka deklaruar: “1. *Kursime nga të ardhurat e viteve të kaluara gjendje në cash të kaluara në depozitën bankare ekzistuese Banka Amerikane e Shqipërisë, në vlerën 850.000 lekë*. 2. *Kursime nga të ardhurat vjetore dhe interesat bankare depozitë pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, në vlerën 150.000 lekë*”.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, subjekti ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore 700.000 lekë; depozitë pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë krijuar nga të ardhurat, gjendja cash e trashëguar nga viti 2006 [600.000 lekë] dhe kursimet e vitit 2007, vlera 1.000.000 lekë; gjendje cash e krijuar nga kursimet e vitit 2007, 300.000 lekë*. Në këtë deklaratë, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *pakësim i depozitës pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë, për likuidimin e vlerës së apartamentit 2.000.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, subjekti ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe interesi i depozitës bankare (gjendje cash), 500.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe interesi i depozitës bankare (gjendje cash) 500.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, subjekti ka deklaruar *kursime nga të ardhurat vjetore dhe interesi i depozitës bankare 700.000 lekë. Depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” krijuar nga gjendja cash trashëguar nga vitet e mëparshme, 1.000.000 lekë*.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2011, subjekti ka deklaruar *depozitë pranë “Raiffeisen Bank” nga gjendje cash e trashëguar nga viti 2010, në vlerën 1.000.000 lekë*.

19.6. Në funksion të verifikimit të mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme kursimet *cash* të deklaruara, në Kolegj u përllorarit *mundësia për kursim* e familjes H. për periudhën 2004-2010 [me konsideratë faktin që në *deklaratë e personit që mbart detyrimin për deklarim 2003*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar kursime në *cash*]. Nga analizimi i deklaratave periodike, trupit gjykues i rezulton që subjekti i rivlerësimit: (i) deklaroi t’i ketë përdorur në vitin 2006 kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat e interesave privatë të viteve 2004 dhe 2005; (ii) kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat e interesave privatë 2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi t’i ketë përdorur në vitin 2007; (iii) kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat e interesave privatë 2007, 2008, 2009 dhe 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi t’i ketë përdorur për krijimin e depozitave në vitin 2011 [më 12.01.2011 pranë “Intesa Sanpaolo Bank” ShA dhe më 13.04.2011 pranë “Raiffeisen Bank” ShA]. Më tej, rezulton që diferenca së bashku me kursimet nga të ardhurat nga pagat dhe likuiditetet e tërhequra nga bankat deri më 19.07.2011, është përdorur për shumën 7.000 euro paguar në “Tirana Bank” ShA, në këtë datë. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi *kursime*

nga të ardhurat vjetore dhe interesi i depozitës bankare, 700.000 lekë, pa specifikuar nëse kursimet ishin në bankë apo gjendje *cash* në banesë. Në pyetësoin e datës 23.04.2020, subjekti ndër të tjera ka sqaruar se kursimet ndodhen në llogari rrjedhëse 514.000 lekë, pjesa tjetër *cash* në banesë. Rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj treguan që subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kursente shumën e deklaruar *cash* në vitet përkatëse dhe në fund të vitit 2010, rezultoi të ketë pasur gjendje *cash* në banesë shumën 1.486.000 lekë [300.000 lekë viti 2007, 500.000 lekë viti 2008, 500.000 lekë viti 2009 dhe 186.000 viti 2010].

19.7. Nga aktet e përcjella në Komision nga bankat e nivelit të dytë, trupit gjykues i rezultoi se nga lëvizjet e llogarisë bankare³⁷ në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA në emër të dy bashkëshortëve, rezultoi se A. dhe Valdete Hoxha të kenë depozituar pranë kësaj banke, më 12.01.2011, shumën 1.000.000 lekë, ndërsa nga lëvizjet e llogarive bankare³⁸ në “Raiffeisen Bank” ShA, rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë depozituar në llogari depozite më datë 13.04.2011, shumën 1.000.000 lekë.

19.8. Në kushtet kur nga analiza financiare e kryer në Kolegj u provua mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kursyer me të ardhura të ligjshme shumat e deklaruara si kursime në *cash* në deklaratat e interesave private vjetore, në fund të vitit 2010 subjekti dhe personi i lidhur, kanë rezultuar me gjendje *cash* në shumën 1.486.000 lekë. Në kushtet kur gjendje *cash* është deklaruar të jetë përdorur për krijimin e depozitës 1.000.000 lekë më datë 12.01.2011, në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA dhe, për pasojë, gjendja e mbetur e likuiditeteve në *cash* më datë 13.01.2011 rezultoi në vlerën 486.000 lekë [1.486.000 lekë - 1.000.000 lekë]. Analiza financiare e kryer për periudhën 13 janar 2011 - 19 korrik 2011, duke përfshirë gjendjen në *cash* të mbetur [486.000 lekë], krijimin e depozitës në shumën 1.000.000 lekë në “Raiffeisen Bank” ShA, [të krijuar nga akumulimet e të ardhurave nga pagat në llogarinë respektive, me balancë të mbartur nga viti 2010 në shumën 513.686 lekë, shtuar kursimet nga pagat për periudhën janar-prill 2011 dhe 150.000 lekë, depozituar më 13.04.2011 nga gjendja *cash*] dhe pagesën e shumës 7.000 euro për automjetin [konvertuar në 972.230 lekë], rezultoi një balancë negative në shumën (-) 46.584 lekë. Kjo vlerë çmohet nga trupi gjykues në vlerë jo domethënëse për t'u konsideruar pamjaftueshmëri në drejtim të pasojës në procesin e rivlerësimit.

19.9. Komisioneri Publik ka argumentuar se nëse në analizën financiare për periudhën nga 1 janari 2011-19 korrik 2011, do të përfshiheshin shpenzimet për një udhëtim të kryer nga personi i lidhur [vajza] në periudhën 10.7.2011-12.8.2011, sipas jurisprudencës së Kolegjit dhe jo sa përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 47.714 lekë, diferenca negative lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro do të thellohej. Trupi gjykues i Kolegjit merr në konsideratë deklaratën noteriale të personit tjetër të lidhur, znj. J. dhe bashkëshortit të saj, të depozituar me parashtrimet në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, sipas së cilës deklarohet se udhëtimi është bërë me ftesën e tyre dhe të gjitha shpenzimet janë mbuluar prej tyre. Për këtë arsye, shpenzimet e udhëtimit të personit të lidhur u përfshinë në Kolegj në analizën financiare të familjes J. në kuadër të verifikimit të mundësisë financiare të tyre për dhuratat dhe huan dhënë të bijës së subjektit të rivlerësimit. Nga kjo analizë rezultoi mjaftueshmëri financiare [shih paragrafët 14.10 dhe 14.11 të këtij vendimi].

- 20.** Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në parimin e proporcionalitetit, vlerëson se bilanci negativ i konstatuar në shlyerjen e huas nga S. H. kundrejt hallës së saj S. J. dhe mungesa e burimeve financiare për këtë hua nuk mund të shërbejë për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi se ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

³⁷ Përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 05.03.2019, të “Intesa Sanpaolo Bank” ShA.

³⁸ Përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2019, të “Raiffeisen Bank” ShA.

21. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, vendimi nr. 269, datë 01.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.09.2022.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtari Sokol Çomo, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, por në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, vendimmarrjen time e kam bazuar vetëm në fakte juridike të natyrës procedurale dhe zbatimin e legjislacionit procedural mbi këto fakte, duke mos marrë në shqyrtim faktet juridike të natyrës materiale mbi të cilat ishte ngritur fillimisht ankimi i Komisionerit Publik, si dhe zbatimin e legjislacionit material mbi to, sikundër ka vepruar shumica e trupit gjykues.
2. Vendimi objekt shqyrtimi iu nënshtrua kontrollit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), mbi bazën e ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik Dariel Sina, në të cilin ish-in parashtuar shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave kundërshtohet ky vendim, si dhe kërkimi alternativ që në përfundim të një hetimi të plotë bazuar në shkaqet e ankimit, Kolegji të vendosë *ndryshimin e vendimit nr. 269, datë 01.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ose lënien në fuqi të këtij vendimi*, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.
3. Në përputhje me nenin F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të sipërcituar, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të Komisioneres Publike Irena Nino dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit.

Pas përfundimit të hetimit gjyqësor, në fazën e bisedimeve përfundimtare të palëve, Komisionerja Publike Irena Nino u shpreh para trupit gjykues: *Në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse praktika ka treguar, kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mund të jetë alternativ kur rrethanat e faktit e lejojnë atë. Në këto kushte, për rastin konkret objekt gjykimi nga hetimi gjyqësor dhe në vlerësim të provave të administruara, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësojmë se nuk mund të kërkohet cenimi i vendimit. Për sa u arsyetua, përfundimisht, kërkohet lënien në fuqi të vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

4. Bazuar në këto fakte juridike të natyrës procedurale, konstatoj se ankuesi, në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, kërkoi përfundimisht nga Kolegji që vendimi i kundërshtuar nëpërmjet ankimit të lihej në fuqi. Në vlerësimin tim, në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016, Institucioni i Komisionerëve Publikë, si përfaqësues i interesit publik, disponon në mënyrë të plotë dhe të pavarur të drejtën e ushtrimit të ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Si pasojë e kësaj të drejte ligjore, Institucioni i Komisionerëve Publikë gëzon në mënyrë ekskluzive edhe të drejtën e disponimit mbi ankimin e ushtruar prej tij.

Në çështjen objekt shqyrtimi, referuar sa më sipër, vlerësoj se, nëpërmjet kërkesës për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit objekt ankimi, Komisionerja Publike ka pranuar në mënyrë të qartë se shkaqet mbi të cilat është ushtruar ankimi, pas shqyrtimit të tyre nga Kolegji në

seancë gjyqësore publike, u vlerësuan prej saj se nuk mund ta cenojnë tanimë vendimin e kundërshtuar nëpërmjet ankimit. Një kërkim i tillë i Komisioneres Publike, në gjykimin tim përbën në thelb veprimin procedural të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për institutin procedural të “heqjes dorë nga ankimi”, të përcaktuar shprehimisht në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile. Bazuar në këtë institut procedural, vlerësova se, pas kërimit përfundimtar të Komisioneres Publike, Kolegji nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt ankimi dhe, për rrjedhojë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmova të mos marr në analizë shkaqet e ngritura në ankim.

5. Në këto kushte, vlerësova se pasoja e vetme ligjore për situatën faktike procedurale, si më sipër analizuar, duhet të ishte lënia në fuqi e vendimit objekt ankimi, me nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha.

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes nr. 42/2020 (JR), datë 30.09.2020, jam kundër vendimit nr. 36 (JR), datë 30.09.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënie në fuqi e vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Valdete Hoxha. Vlerësimin tim, kundër zgjidhjes përfundimtare të kësaj çështjeje, e mbështes në arsyetimin në vijim.
2. Në Kolegj, përgjatë shqyrtimit të çështjes u shqyrtuan shkaqet ankimore të ngritura nga Komisioneri Publik, si më poshtë:
 - *Mbi aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur S. J., me fokus shpenzimet e mundësinë për kursim të familjes së saj, për të dhënë dhurimet në shumën 11.500 CAD dhe huat në shumën 93.952,08 CAD, për shkollim vajzës së subjektit të rivlerësimit Valdete Hoxha.*
 - *Mbi detyrimet e personit të lidhur, vajzës së subjektit S. H., ndaj hallës S. J., për huat e dhëna në shumën 93.952,08 CAD.*
 - *Lidhur me pagesën e shumës 7.000 euro, për blerjen e makinës “Ford Focus”, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit të saj.*

I. Për pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë

3. Referuar deklaramentit në deklaratë e pasurisë *vetting*, objekt kontrolli për procesin e rivlerësimit në zbatim të ligjit nr. 84/2016, rezultoi e deklaruar pasuria e paluajtshme, apartament banimi me sipërfaqe 63 m² dhe shtesë me sipërfaqe 62 m², në total 125 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, e përfituar me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.05.2007, me shitës shtetasit Z. dhe S. J. [motra e bashkëshortit të subjektit] dhe blerës shtetasit A. dhe Valdete Hoxha, në vlerën 2.000.000 lekë.
4. Për këtë pasuri, nga Komisioneri Publik, i cili mbron interesin publik, si në ankim, por edhe përgjatë procesit të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, parashtrime e konkluzione përfundimtare, në asnjë moment nuk u kërkua kontrolli i kësaj pasurie të paluajtshme, por u ndal kryesisht në kontrollin ekonomik-financiar të familjes J., personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit dhe të një pasurie të luajtshme, automjet i markës “Ford Focus”.
5. Në cilësinë e relatores, pavarësisht problematikave të konstatuara të kësaj çështjeje që duheshin sqaruar, i jam drejtuar subjektit të rivlerësimit në seancën gjyqësore publike të datës 13.09.2022, me pyetjen për vlerën e blerjes së këtij apartamenti, 2.000.000 lekë, me sipërfaqe 125 m², në qytetin e Tiranës, pasi pa hyrë në analizë, këtë çmim e konsideroj fiktiv dhe të pabazuar në raport me çmimin e tregut të lirë për qytetin e Tiranës. Edhe pse nga ana ime u ngrit problematika e çmimit joreal të blerjes së këtij apartamenti, shumica e trupit gjykues nuk u ndal të analizonte këtë pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në kushtet kur të krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit është i pasinqertë, për arsyet e mëposhtme.
6. Referuar të dhënave zyrtare të vlerës së tregut në vitin e blerjes 2007, për sipërfaqe 125 m², në Tiranë, çmimi i tregut do të rezultonte në vlerën 12.125.000 lekë, i llogaritur bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 04.04.2007, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2007”, ku në tabelën nr. 2 “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2007”, për qytetin e Tiranës, është përcaktuar çmimi 97.000 lekë/m². Shpjegimet e subjektit përgjatë këtij procesi nuk kanë qenë bindëse për të justifikuar përfitimin e këtij apartamenti në një vlerë disa herë më të ulët se çmimi i tregut.

7. Vlera disa herë më e ulët e përfitimit të kësaj pasurie, gjykoj se edhe në perceptimin e një qytetari të thjeshtë, do të dukej alogjike dhe aspak bindëse dhe, për këtë arsye, në vlerësimin tim, ky fakt, duhet të konsiderohej i mjaftueshëm për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra pa nevojën e trajtimit të shkaqeve ankimore, pasi mungesa e burimeve të ligjshme rezulton në vlerën -9.736.096 lekë, që në mënyrë të pakundërshtueshme do të çonte në zbatimin e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, në pamjaftueshmërinë e parashikuar nga neni 61, pika 3 e këtij ligji.
8. Nuk pajtohem kurrsesi me qëndrimin e shumicës së trupit gjykues, të cilët çmojnë se shqyrtimi i çështjes nuk duhet të shkojë përtej shkaqeve ankimore. Jam absolutisht kundër këtij qëndrimi, e kam kundërshtuar fort dhe vijoj ta kundërshtoj, pasi Kolegji është organ Kushtetues, i cili mbron interesin publik, të drejtën e subjektit në këtë proces rivlerësimi, por nuk qëndron brenda shkaqeve të ankimit në rastet kur konstaton që kontrolli i vendimit, ka nevojë të shkojë më tej, si në rastin objekt shqyrtimi.
9. Pavarësisht se nga Komisioneri Publik nuk u kërkua kontrolli i kësaj pasurie dhe në konkluzionet përfundimtare u kërkua lënia në fuqi e vendimit të Komisionit, pa analizuar realisht provat e sjella nga subjekti, çmoj se Kolegji, në zbatim të ligjit, në këtë rast duhet të kishte kryer kontrollin në tërësi të vendimit të Komisionit. Unë, gjyqtare në pakicë, e konsideroj ankimin si mjet procedural që vë në lëvizje Kolegjin dhe më pas çështja është objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Kolegjit, pavarësisht kërkimeve të Komisionerit Publik. Përgjatë gjykimit, në Kolegj, Komisioneri Publik mund t’i qëndrojë tërësisht ankimit, apo mund të bindet nga parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë gjyqësore publike, por Kolegji në përmbushje të detyrave dhe rolit kushtetues vijon shqyrtimin e çështjes, pavarësisht qëndrimin të Komisionerit Publik, në mbrojtje të interesit publik.
10. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se çmimi i blerjes së pasurisë së paluajtshme objekt shqyrtimi është kushtëzuar nga rrethana të tilla si pozicioni i apartamentit, zona ku ndodhet, lloji i pallatit ekzistues me strukturë parafabrikat, si dhe rrethanat e posaçme për shkak të lidhjes së ngushtë mes bashkëshortit e motrës së tij, të cilët kanë synuar ta ndihmojnë, në vlerësimin tim, nuk janë bindëse.
11. Bindjen që çmimi i përcaktuar në kontratë nuk është real ma përforcon fakti që familja J., vetëm një vit para kryerjes së këtij transaksioni, kishte blerë banesë në adresën: {***}, Street, {***}, Alberta, Kanada, nëpërmjet një kredie bankare të financuar nga Bank of Montreal, në vlerën 246.500 CAD, për të cilën paguante këst mujor në vlerën 1.016 CAD dhe vetëm 3 vjet më pas, me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.7.2010, bashkëshortët Z. dhe S. J. kishin porositur pranë shoqërisë “{***}” ShPK, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, apartament banimi, në vlerën 75.707 euro, 95% të së cilit e kanë likuiduar deri më datë 19.07.2010. Në terma të një logjike ekonomike, askush nuk shet apartament në vlerë disa herë më të ulët se çmimi i tregut, kur ndërkohë investon në blerjen e pasurive të paluajtshme, shtëpi në Kanada dhe apartament në Shqipëri.
12. Për gjithë sa sipër, vlerësoj se shumica e trupit gjykues ka gabuar në qëndrimin e saj, duke mos marrë në analizë pasurinë e paluajtshme apartament banimi të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi dukshëm është një deklaram i pamjaftueshëm dhe i shoqëruar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -9.736.096 lekë.

II. Për aftësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. S. J.

13. Lidhur me shkakun kryesor të ankimit të Komisionerit Publik, për vlerësimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, znj. S. J., për justifikimin bindshëm të huas së dhënë së bijës së subjektit të rivlerësimit, S. H., në shumën totale prej 93.952,08 CAD [dollarë kanadez],

për mbulimin e shpenzimeve të studimit në Kanada gjatë viteve 2012-2016 dhe dhurimet në shumën totale 11.500 CAD.

14. Në vlerësimin tim, mbetet i paqartë fakti përse të jetë vendosur marrëdhënia e huas, mes të bijës së subjektit S. H. dhe hallës së saj, S. J., prej muajit shtator të vitit 2012 kur mbesa ka filluar studimet në Universitetin e Albertës, Kanada, deri në janar të vitit 2016, për shumën 93.952,08 CAD, pa konsideruar mbulimin e shpenzimeve të jetesës së saj prej familjes J. për të njëjtën periudhë, pasi si konfirmon subjekti i rivlerësimit, ajo dhe bashkëshorti i saj *nuk kanë bërë pagesa për shkollimin e vajzës së tyre pranë Universitetit Alberta* dhe nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit, përcjellë nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, rezultojnë që pas likuidimit të apartamentit nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në shumën 2.000.000 lekë, subjekti ka filluar të krijojë kursime, depozitë në bankë³⁹, të cilat janë rritur nga 3.159.574 lekë në fund të vitit 2011, në 4.421.446 lekë në fund të vitit 2015, për të kulmuar në 4.636.684 lekë në fund të vitit 2016. Për këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga relatorja e çështjes në seancë publike, në vijim të përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e datës 04.03.2019, shprehet se: *ka qenë marrëdhënia e ngushtë që vajza ka me hallën e saj dhe dëshira e hallës dhe familjarëve të saj që vajza të studiojë atje, mundësia ekonomike e tyre, si dhe fakti që subjekti dhe bashkëshorti janë kujdesur për prindërit e bashkëshortit dhe halla e vajzës ka qenë shumë mirënjohëse dhe në çdo moment e disponueshme të ndihmojë familjen subjektit*. Në gjykimin tim, gjyqtare në pakicë, qëndrimi i mbajtur nga subjekti në seancën gjyqësore publike, përsëri nuk arriti të më bindë, pasi është alogjike që prindërit akumulojnë kursime në sasi të konsiderueshme në llogaritë e tyre bankare dhe nuk investojnë në studimet e së bijës, por lejojnë përfshirjen e saj në marrëdhënie detyrimi financiar me të tretë.
15. Për shkak të dhurimeve të bëra prej znj. S. J., vëllait dhe mbesës, duke filluar prej vitit 2010 deri në vitin 2012, si dhe huave dhënë kësaj të fundit për pagesën e studimeve për vitet 2012-2016, është klasifikuar person tjetër i lidhur, me cilësinë e dhurueses dhe huadhënëses, me marrëdhënie të tilla të konfirmuara, për të cilat neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të shumave të dhuruara apo të dhëna hua. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore dhe për faktin se marrëdhënia e personit tjetër të lidhur me bashkëshortin dhe vajzën e subjektit të rivlerësimit shtrihet për një periudhë të gjatë kohore 2010-2016, në vlerësimin tim, shumica nuk duhet të ishte mjaftuar me kryerjen proporcionale të verifikimit të mundësisë dhuruese dhe huadhënëse të shtetasës S. J., por duhet të kishte bërë një analizë financiare më gjithëpërfshirëse, duke përllogaritur në të edhe shpenzimet për udhëtimet që familja J. ka kryer jashtë vendit ku jeton ose të paktën ato drejt Shqipërisë, gjë që në vlerësimin tim do të kishte ndryshuar rezultatin në pamjaftueshmëri të të ardhurave nga burime financiare të ligjshme të personit tjetër të lidhur S. J., për të kryer dhurimet dhe financuar huat, përkatësisht.
16. Për verifikimin e mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur, në kuadër të regjimit familjar, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 2010 me dhurimin e parë, deri në fund të vitit 2016 me financimin e kësaj të fundit të huas, si pasqyruar në tabelën “Analizë Financiare”, në vijim të paragrafit 35.2.1.2.4. të vendimit të ankimuar, faqe 17. Nga shqyrtimi i kësaj analize konstatohet se përllogaritja e mundësisë financiare për vitin 2010 është bërë pa përfshirë vlerën e investimit për apartamentin në Tiranë⁴⁰. Në të kundërt, rezultati financiar

³⁹ Dy depozita në “Raiffeisen Bank” ShA, ku subjekti është titullare e llogarisë dhe një depozitë bashkë emërore në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

⁴⁰ Vlera e apartamentit, e përfutur prej porositësve Z. dhe S. J., me aktmarrëveshje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.7.2010, nga shoqëria “{***}” ShPK, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, është likuiduar sipas deklaratës së datës 12.07.2010, në këtë mënyrë: (i) 1.000 euro më datë 12.07.2010 [si paradhënie me qëllim blerjen e këtij apartamenti objekti i aktmarrëveshjes mes palëve]; (ii) 70.922 euro më datë 19.07.2010; si dhe (iii) 3.785,36 euro me marrjen e hipotekës [5 %].

tregon pamjaftueshmëri për të krijuar kursime, për të likuiduar vlerën 71.922 euro të apartamentit deri më 19.07.2010, si dhe dhurimin 2.000 CAD [apo 208, 580 lekë].

17. Në vlerësimin tim në cilësinë e gjyqtarës relatores, në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Valdete Hoxha, duhet t'i ishte kushtuar rëndësi lëvizjeve të llogarive bankare në monedhën dollarë kanadez të shtetasit Z. J., pranë "Raiffeisen Bank" ShA, në të cilën është transferuar shuma 58.891 CAD, që sipas subjektit ka shërbyer për shlyerjen e çmimit të apartamentit të blerë nga familja J., në vitin 2010, pa provuar origjinën e kësaj shume, për të bërë të besueshëm faktin e ligjshmërisë së saj për efekt të procesit të rivlerësimit. Për të qartësuar se si erdhën nga Kanadaja shumat e depozituara në llogaritë bankare të shtetasit Z. J., në "Raiffeisen Bank" ShA, në Shqipëri, u pyet prej meje subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 13.09.2022. Subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm dhe nuk provoi me dokumentacion mënyrën e transferimit të shumës 58.891 CAD në llogarinë aktuale, si dhe shumat e tjera depozituar *cash* në arkë. Në përfundim të arsyetimit më sipër, konkludoj se subjekti i rivlerësimit anashkaloi qëllimisht detyrimin ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të shumave depozituar në llogaritë bankare të shtetasit Z. J., në "Raiffeisen Bank" ShA.

III. Lidhur me mundësinë financiare të vajzës së subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e huas në vitin 2016

18. Ndryshe nga shumica e trupit gjykues, i cili konkludoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e huas nga S. H. në vlerën (-) 3.325 CAD [konvertuar në 312.610 lekë], në vlerësimin tim, në linjë edhe me diskutimet përfundimtare të Komisioneres Publike, sipas të cilës – dokumentet bankare depozituar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës i perkasin periudhës 01.01.2015 – 31.12.2016, ndërkohë që në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016 dhe gjatë hetimit administrativ shlyerja e huas është deklaruar të ketë filluar nga muaji maj 2016 – pretendimet e subjektit të rivlerësimit se shumat e kaluara në favor të djalit të personit të lidhur, L. J., kanë shërbyer për shlyerjen e huas së deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, mbetën në nivel deklarativ – aktet e administruara me këto parashtrime, arritën të provonin vetëm likuidimin e shumës 4.400 CAD nga detyrimi 13.775,48 CAD. Në këto kushte, personi i lidhur S. H., ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 9.375,48 CAD [apo 890.000 lekë], për shlyerjen e këtij detyrimi për periudhën maj-dhjetor të vitit 2016.

IV. Lidhur me blerjen e automjetit të markës "Ford Focus"

19. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në linjë me Komisioneren Publike për mos përfshirjen e kursimeve *cash* në analizën e burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit në vitin 2011, nuk mund të pranohet pasi nuk bazohet në sa ka deklaruar subjekti në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar pagesën në shumën 7.000 euro, për një diferencë negative prej -387.091 lekë.

V. Konkluzione

20. Duke u bazuar në prova dhe në ligj, për gjithë sa arsyetuar më sipër, objekti kryesor i kësaj çështje është marrëdhënia mes subjektit të rivlerësimit, bashkëshortit, fëmijëve të saj dhe familjes J.. Problematikat e kësaj marrëdhënie në kuadër të procesit të rivlerësimit, konsistojnë, *së pari* në shitjen e apartamentit nga familja J. disa herë më pak se vlera e tregut në vitin 2007, ndërkohë që kjo familje investonte në krijimin e pasurive të paluajtshme, *së dyti* dhurimet nga familja J. në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare për vitin 2010, *së treti* dhënia e huave për shkollim vajzës së subjektit, ndërkohë që vetë subjekti kursente në llogaritë e saj bankare

shuma potenciale, *së katërti* mungesa e burimeve të vajzës së subjektit për të shlyer huan në vitin 2016, *së pesti* blerja nga familja J. e një apartamenti në Tiranë, në vitin 2010, nëpërmjet transaksioneve që nuk provojnë origjinën e shumave të hyra në llogaritë bankare më krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklaram, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

21. Në përmbledhje të konkluzioneve më sipër, çmoj se shumica e trupit gjykues, gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, duhet të kishte analizuar dhe vlerësuar në harmoni provat ligjore të administruara dhe situatën faktike të subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur, për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke pasur parasysh se barra e provës i përket subjektit të rivlerësimit, që në vlerësimin tim nuk ishte aspak bashkëpunuese. Në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e këtij ligji, shumica e trupit gjykues duhet të vendoste ndryshimin e vendimit nr. 269, datë 01.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Valdete Hoxha, pasi referuar kërkesave të ligjit për rivlerësimin, ky subjekt nuk e meriton të jetë në radhët e sistemit të drejtësisë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi